




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri



100 Vjet Pavarësi

6534
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 27.11.2012

UDHËZIM

Nr. 35, datë 27.11.2012

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2013

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

U D H Ë Z O J:

1. Viti shkollor për Maturën 2013 të përfundojë në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 16, datë 24.07.2012 "Për vitin shkollor 2012 - 2013 në sistemin arsimor parauniversitar".
2. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2013 janë:
 - a. Gjuhë shqipe dhe letërsi;
 - b. Matematikë;
 - c. Provimet me zgjedhje.

3. Lista e lëndëve të provimeve me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2013 është sipas tabelës sa më poshtë:

Nr	Lënda	Kredite
	I. Për të gjitha shkollat e mesme	
1	Gjuhë e huaj e parë	10
2	Gjuhë e huaj e dytë	6
3	Letërsi e thelluar	5
4	Matematikë e thelluar	5
5	Kimi bërthamë	4
6	Kimi e thelluar	6
7	Fizikë bërthamë	4
8	Fizikë e thelluar	6
9	Biologji bërthamë	4
10	Biologji e thelluar	6
11	Histori bërthamë	5
12	Histori e thelluar	9
13	Gjeografi bërthamë	5
14	Gjeografi e thelluar	7
15	Ekonomi bërthamë	2
16	Ekonomi e thelluar	4
17	Teknologji bërthamë	2
18	Teknologji e thelluar	4
19	Qytetari	3
20	Psikologji	2
21	Filozofi	2
22	Sociologji	2
	II. Vetëm për shkollat artistike	
23	Histori muzike	6
24	Histori arti	6
25	Histori baleti	3
	III. Vetëm për shkollat profesionale	
26	Teori profesionale	8

